



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**  
**Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority**

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbështetje në nenit 28 paragrafi 1.2, nenit 29 paragrafi 1, nenit 35 paragrafi 4 e 5, neni 54 paragrafi 1.9 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03/L-229 (Gazeta Zyrtare nr.88/25), në mbledhjen e mbajtur më 25.11.2016 mori në shqyrtim ankesën e z. Liridon Aliut me nr. prot. 145/13 të datës 09.09.2013 me pretendimet për keqpërdorim të pozitës dominuese nga ana e Kompanisë transportuese të udhëtarëve “24 Yjet” që qarkullon në relacionin Hajvali-Prishtinë-Hajvali dhe nxjerrë këtë:

**KONKLuzion**

1. Konstatohet se nuk është çrregulluar konkurrenca në tregun përkatës në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës,
2. Komisioni konstaton se lënda me nr. të protokollit: 145/13 e datës 09.09.2013 merr epilogun sikur në pikën 1 të këtij dispozitivi dhe
3. Rasti konsiderohet i mbyllur.

**ARSYETIM**

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës më datë 09.09.2013 ka pranuar ankesën me nr. të protokollit 145/13, nga z. Liridon Aliu, adresa Hajvali, Prishtinë. Ankuesi pretendon në keqpërdorim të pozitës dominuese nga Kompania “24 Yjet”, e cila si veprimtari ka transportin e udhëtarëve në relacionin Hajvali-Prishtinë-Hajvali dhe thekson se:

1. Kompania “24 Yjet” për një stacion edhe deri në 100 metra, ka çmimin e biletës prej 0.50 euro dhe nuk ka çmim tjetër më të ulët,
2. Kompania “24 Yjet” nuk ka konkurrencë dhe orari i qarkullimit të linjës transportuese nuk respektohet dhe
3. Konduktori i Kompanisë “24 Yjet” nuk e ka ndaluar autobusin te zyra e ankuesit, duke zbritur dhunshëm atë nga autobusi.

Për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me pretendimet e ankuesit Inspektorët hetues kanë inspektuar linjen e transportit Hajvali-Prishtinë-Hajvali dhe pas mbledhjes së të dhënave dhe analizave kanë konstatuar se çmimin e biletave për Transportin Rrugor të Udhëtarëve në Komunën e Prishtinës e rregullon Drejtoria Komunale për Ekonomi dhe Zhvillim. Në bazë të çmimoreve së Komunës çmimi i biletave ndahet në zona, ku relacioni Hajvali-Prishtinë është në zonën e dytë dhe çmimi i biletës është 0.50 euro.

Inspektorët hetues kanë vërtetuar se Kompania “24 Yjet” ka dy lloje të çmimit të bilëtave, në zonën e parë çmimi është 0.40euro, ndërsa në zonën e dytë 0.50 euro, kështu që nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit për keqpërdorim të pozitës dominuese sepse përfaqësuesit e kompanisë i'u kanë përmbajtur çmimorese së caktuar nga Komuna e Prishtinës.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në teren lidhur me pretendimet e ankuesit, se kompania nuk i përmbahet orarit të qarkullimit të linjës transportuese, inspektorët hetues të rastit kanë inspektuar qarkullimin e linjës Hajvali–Prishtinë–Hajvali dhe kanë vërtetuar se kompania “24 Yjet” i përmbahet orarit të udhëtimit, të caktuar nga Komuna e Prishtinës, sipas Ligjit për Transportin Rrugor të Udhëtarëve.

Lidhur me pretendimin se konduktori i Kompanisë “24 Yjet” nuk e ka ndalur autobusin tek zyra e ankuesit dhe se e ka zbritur në mënyrë të dhunshme nga autobusi, Komisioni për këtë rast palën ankuese e referon tek institucionet të cilat janë kompetente për ruajtjen e rendit publik.

Komisioni në bazë të iniciativës nga neni 34 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës , gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun relevant, konstaton se nuk ka argumente për fillimin e procedurës në kuptim të dispozitave të këtij Ligji edhe pas kalimit të 10 muajve të monitorimit të tregut relevant.

Rasti si i tillë mbyllet sepse nuk ka shkelje të nenit 11 për Keqpërdorim të Pozitës Dominuese dhe bazuar në nenin 35 paragrafi 4 e 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, ky rast merr epilogun si ne dispozitiv të këtij **KONKLuzioni**.

#### **Këshilla juridike:**


Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të inicioj konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative .

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- Arkiva dhe
- Ankuesi z. Liridon Aliu, Hajvali – Prishtinë

#### **KOMISIONI I AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS**


  
Ahmet Krasniqi  
Zv. Kryetar

  
Valon Prestreshi  
Kryetar

  
Fatime Haziri  
Anëtare

  
Muhamed Krasniqi  
Anëtar



  
Shaqir Morina  
Anëtar